

VENDIM
Nr. 233, datë 2.11.2018

MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR DISA AMENDIME PËR PROPOZIMIN E TË GJITHA OST-ve, MBI “UDHËZUESIN PËR KËRKESAT ORGANIZATIVE, ROLET DHE PËRGJEGJËSITË, NË LIDHJE ME SHKËMBIMIN E TË DHËNAVE” (KORP)

Në mbështetje të neneve 7; 16; 56 dhe 63, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 40, pika 6, të Rregullores së Komisionit të BE-së 2017/1485, “Mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike (SO GL)”, (*Security of Operation Guideline, or Commission Regulation (EU) 2017/1485 of 2 August 2017 establishing a guideline on electricity transmission system operation*/Rregullorja e Komisionit të BE-së 2017/1485 ose Udhëzuesi mbi Sigurinë Operacionale); të nenit 26, të “Rregullave të organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin të Bordit të ERE-s, nr. 96, datë 17.6.2016, si dhe duke konsideruar se Operatori i Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike OST sh.a. është anëtare me të drejta të plota e ENTSO-E, Bordi i ERE-s, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licencimit dhe e Monitorimit të Tregut, mbi fillimin e procedurës për miratimin e disa amendimeve për propozimin e të gjitha OST-ve, “Mbi udhëzuesin për kërkesat organizative, rolet dhe përgjegjësitë, në lidhje me shkëmbimin e të dhënave” (KORP),

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 159, datë 9.7.2018, miratoi “Udhëzuesin për kërkesat organizative, rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave” (KORP).
 - Në vijim të këtij miratimi, OST sh.a., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 674 prot., datë 22.10.2018, ka dërguar për miratim, amendimet për propozimin e të gjithë OST-ve mbi “Udhëzuesin për kërkesat organizative, rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave” (KORP).
 - Pas shqyrtimit nga ENTSO-E në cilësinë e hartuesit të KORP-së, në datën 9 tetor 2018, u krye votimi në lidhje me këto amendime, i cili rezultoi në favor të miratimit të tyre.
 - KORP-ja është propozim i të gjitha OST-ve të ENTSO-E për kërkesat themelore organizative, rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave, draftuar në përputhje me nenin 40, pika 6 të Rregullores së Komisionit të BE-së 2017/1485, “Mbi operimin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike SO GL” (*Security of Operation Guideline, or Commission Regulation (EU) 2017/1485 of 2 August 2017 establishing a guideline on electricity transmission system operation*/Rregullorja e Komisionit të BE-së 2017/1485 ose Udhëzuesi mbi Sigurinë Operacionale).
 - Versioni i amenduar dhe i miratuar i këtij akti është publikuar dhe në faqen zyrtare të ENTSO-E, ku OST sh.a. është anëtare me të drejta të plota.
 - Amendimet për kërkesat organizative, rolet dhe përgjegjësitë në lidhje me shkëmbimin e të dhënave” (KORP), janë bashkëlidhur këtij vendimi dhe konsistojnë kryesisht në një sistemim sintaksor dhe leksik më të mirë të strukturës së këtij udhëzuesi, me qëllim kuptimin më të mirë nga ana e palëve.
- Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën për miratimin e disa amendimeve për propozimin e të gjitha OST-ve mbi “Udhëzuesin për kërkesat organizative, rolet dhe përgjegjësitë, në lidhje me shkëmbimin e të dhënave” (KORP). (Drafti me ndryshime bashkëlidhur këtij vendimi.)
2. Versioni në gjuhën e origjinës (anglisht), ka përparësi në rast mosdakordësie në interpretim nga palët të versionit shqip.
3. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit do të njoftojë palët e interesuara.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Petrit Ahmeti